

NJE LAJM DASHAKEQ QE U PERGENJESHTRUA NGA FAKTET



Së fundmi, dikush në rrjetet sociale, hodhi një “lajm” për “njerëz të armatosur” në Manastirin “Burimi Jetëdhënës” të Dhërmiut. Pas një kontrolli nga policia e Himarës, u deklarua se u gjet vetëm një çakmak në formë pistolete dhe se “Në vijim të kontrollit të ambienteve të tjera të manastirit nuk u konstatuan sende të jashtëligjshme apo persona të tjerë.”

Shpifje të këtij lloji kundër Kishës dhe personave të saj nuk janë të reja në internet. E veçanta është se kësaj here iu kushtua një vëmendje e pajustificuar. Duhet falënderuar faqet e mediave që u treguan objektive, por gjithashtu nuk mund të mos vëmë në dukje se në disa prej tyre jo vetëm u botua kjo gënjeshtëri si e mirëqenë, por iu shtuan edhe sajesa fantazioze për gjetje armësh e uniformash ushtarake, duke dëshmuar një qëndrim hapur tendencioz dhe antiorthodhoks, që cenon harmoninë aq të çmuar fetare.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)